



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 17/11 Prot.
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 17 / 11 / 2021

VENDIM

Nr.36, date 17 /11/2021

PËR

PROBLEMATIKAT NE LIDHJE ME FILTRIMET NE DIGEN E HEC KOMAN

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" si dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), në mbledhjen e tij të datës 17.11.2021 mori në shqyrtim informacionin e ardhur nga KESH-i në lidhje me filtrimet në pjesën e poshtme të digës së HEC Koman.

KKDM me shkresën e tij, nr.133 datë 01.11.2021 i kerkoi KESH-it si shfrytëzues i digës, një informacion në lidhje me monitorimin e filtrimeve në digën e HEC-it Koman.

KESH-i me shkresën nr.5344/1 datë 15.11.2012 paraqiti për shqyrtim "Informacionin në lidhje me monitorimin e filtrimeve në digën e HEC-it Koman Janar –Shtator".

KKDM pasi u njoh me materialin e paraqitur dhe mbas diskutimeve të të gjithë anëtarëve në mbledhjen e tij,

VENDOSI:

Ti kërkojë KESH sh.a si shfrytëzues i digës së HEC Koman:

- Vazhdimin e Monitorimit të sasisë dhe cilësisë së ujit të filtrimeve në pjesën e poshtme të digës së HEC Koman; Ky monitorim duhet të kryhet përmes metodave bashkëkohore dhe në kohë reale duke rritur saktësinë e të dhënave dhe shpejtësinë e transferimit të tyre;
- Raportimin çdo 6 muaj të të dhënave të monitorimit të filtrimeve në pjesën e poshtme të digës të shoqëruar edhe me analizën dhe interpretimin e këtyre të dhënave; Ky Raport duhet të shoqërohet me grafikët përkatës të rezultateve të matjeve të filtrimeve në vijim që nga viti 2017 e në vazhdim. Në rast të rritjes së sasisë së filtrimeve mbi 1200 l/sek, KESH duhet të raportojë menjëherë pranë KKDM dhe Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë
- Kryerjen e Batimetrisë së detajuar në një zonë deri në 1 km përpara pjesës së sipërme të digës dhe krahasimin e rezultateve me të dhënat e matjeve të mëparshme batimetrike për të analizuar ndryshimet e mundshme që mund të kenë ndodhur;
- Instalimin e piezometrave shtesë në galerinë fundore të digës për të sqaruar me tej rrugën e filtrimeve dhe për të marrë informacione më të sakta për ndryshime të mundshme të situatës hidrogeologjike për ujrat nëntokësore që rrjedhin në zonë;
- Kryerjen e një studimi me metodat bashkëkohore gjeoelektro-magnetike për të vlerësuar, në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse, rrugën e filtrimeve që vijnë nga ujëmbledhësi dhe dalin në pjesën e poshtme të digës. Ky studim duhet të shoqërohet edhe me analizat dhe rekomandimet përkatës në lidhje me masat që duhet të merren për zvogëlimin e mundshëm të këtyre filtrimeve apo ndonjë riparimi të nevojshëm në perden e cimentimit nëse do të jetë e nevojshme;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Marrjen e masave për rivenien në punë të sistemit ekzistues të monitorimit të ekranit betonarme të digës.
- Krijimin e një ekipi të specializuar për monitorimin e filtrimeve në pjesën e poshtme të digës së HEC Koman si dhe për monitorimin e levizjes së ujërave në trupin e digës.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për zbatimin e këtij Vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

